



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/1612

Datë; 19/09/2022

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja a, b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), Ligjin për financat publike dhe përgjegjësit, dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës, kërkesës së parashtruar nga drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet,

Kryetari i Komunës me datë 19.09. 2022 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Miratohet, kërkesa e drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet, dt.19.09.2022, për revokimin e qasjes në SIMFK për Zyrtarin Kryesor Financiar, z.Halil Shurdhaj.

I I. z.Agush Gashi, caktohet zyrtar alternativ i Zyrtarit Kryesor Financiar, në komunën e Malishevës.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi, autorizohet, drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës

Ekrem Kastrati



Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Palëve të cekura,
3. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE
SKUPŠTINA OPŠTINE MALISHEVO



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 13 /09/2022

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.St.

16/09/2022

01/1606.

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja a, b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës, dhe paramasës dhe parallogarisë së përgatitur nga drejtoria për urbanizëm,

Kryetari i Komunës me datë 01.06. 2022 mori këtë;

VENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 23,262.50 €

I I. Mjetet që ndahen në emër të realizimit të projektit “Ndërtimi i lapidarit të dëshmorit – Afrim Krasniqi” në fshatin Bardh, KK-Malishevës. Ky projekt do të realizohet sipas paramasës dhe parallogarisë së përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë për urbanizëm.

I I I. Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria për urbanizëm, përmes shërbimit të prokurimit publik.

I V. Ky vendim hyn në fuqi me datë, 13.09.2022.

Kryetari i Komunës

Ekrem Kastrati



Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Drejtorisë për urbanizëm,
3. Shërbimit të prokurimit publik,
4. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 14/09/2022

PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMJENJO:

Nr.No.Br.

16/09/2022

01/1605

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për urbanizëm si dhe kërkesës së parashtruar nga drejtoria për urbanizëm,

Kryetari i Komunës me datë 14 .09. 2022 mori këtë;

AKTVENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Miratohet, kërkesa e parashtruar nga drejtoria për urbanizëm, për formimin e komisionit për vlerësimin e dokumentacionit të kandidatit, për konkursin për projektin “ Arkitektonik dhe Urbanistikë, Ndërtimi i Sheshit së Bashku me Parkingun Nëntokësor në Qytetin e Malishevës.

I I. Komisioni formohet në përbërje prej tre (3) anëtarësh me emrat e poshtëshënuar;

- 1. Enver Mazreku-Kryetar i komisionit,
- 2. Jakup Shurdhaj -anëtar,
- 3. Mehdi Krasniqi- anëtar.

I I I. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati



Aktvendimi ju dorëzohet:

1. Komisionit
2. Arkivit të komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



KOMUNA E MALISHEVËS
KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVË



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë: 13/09/2022

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

14/09/2022

01/1602

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për urbanizëm,

Kryetari i Komunës me datë 13 .09. 2022 mori këtë;

AKTVENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Formohet komisioni për pranim teknik të projektit “Ndërtimi i Çerdhes në Malishevë “ sipas kontratës nr.26, me numër të protokollit 03/40, dt.13.07.2020, me numër identifikues të prokurimit 62500.20.049.521 dhe aneks kontratës 03/40, dt.13.07.2021.

I I. Komisioni formohet në përbërje prej tre (3) anëtarësh me emrat e poshtëshënuar;

- 1. Ahmet Morina-Kryetar i komisionit,
- 2. Jakup Shurdhaj-anëtar,
- 3. Mehdi Krasniqi-anëtar

I I I. Ky komision është i obliguar të përgatit raport me shkrim nga dita e hyrjes në fuqi të këtij akti, në lidhje me verifikimin e të gjitha procedurave si dhe realizimin e projekti të lartcekur, konform kontratës dhe **aneks-kontratës** publike të lidhur në mes operatorit ekonomik dhe shërbimit të prokurimit, në emër të KK- Malishevës.

I V. Të gjitha dokumentet si dhe akti i pranimit-dorëzimit teknik duhet të ju nënshtrohen procedurave ligjore, ndërsa çdo devijim do të konsiderohet si shkelje e ligjit, dhe i nënshtrohet sanksioneve sipas ligjit.

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

- 1. Komisionit
- 2. Arkivit të komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



KOMUNES-REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-SKUPŠTINA OPŠTINE MALISHEVE



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë: 05/09/2022

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

12/09/2022

01/1589

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 05.09. 2022 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 352.25 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të sigurimit dhe regjistrimit i automjetit NISAN PARIMERA, me targa 04Z-11-30. Mjetet ndahen sipas kërkesës së parashtruar nga drejtoria për administratë.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria për administratë.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.



Aktvendimi j u dorëzohet :

1. Drejtorisë për administratë,
2. Drejtorisë për ekonomi,financa dhe buxhet,
3. Arkivit të komunës.



KOMUNA E MALISHEVËS

PRANUAR MË: 12/09/2022
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO: 01/1590.
Nr.No.Br.

Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 09/09/2022

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për urbanizëm,

Kryetari i Komunës me datë 09 .09. 2022 mori këtë;

**AKTVENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

I. Formohet komisioni për pranim teknik të projektit “ Riparimi i rrugëve me asfalt në Komunën e Malishevës “ kontrata nr.34, me prot. nr.03/58, dt.15.09.2021, numër identifikues të prokurimit 62500.21.4126.521, aneks kontrata nr.03/02, dt.06.01.2022.

I I. Komisioni formohet në përbërje prej tre (3) anëtarësh me emrat e poshtëshënuar;

- 1. Jakup Shurdhaj-Kryetar i komisionit,
- 2. Mehdi Krasniqi- anëtar,
- 3. Valdete Morina- anëtare.

I I I. Ky komision është i obliguar të përgatit raport me shkrim nga dita e hyrjes në fuqi të këtij akti, në lidhje me verifikimin e të gjitha procedurave si dhe realizimin e projekti të lartcekur, konform kontratës publike të lidhur në mes operatorit ekonomik dhe shërbimit të prokurimit, në emër të KK- Malishevës.

I V. Të gjitha dokumentet si dhe akti i pranimit-dorëzimit teknik duhet të ju nënshtrohen procedurave ligjore, ndërsa çdo devijim do të konsiderohet si shkelje e ligjit, dhe i nënshtrohet sanksioneve sipas ligjit.

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Aktvendimi ju dorëzohet:

- 1. Komisionit
- 2. Arkivit të komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS

REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNES MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVE - OPSTINA OPSTINE MALISHEVO



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 13/09/2022

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRILJENO:

Nr. No. Br.

13-09-2022

01/1598

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja a, b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 13.09. 2022 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 1,410.00 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për ushqim dhe pije, të shkaktuara nga drejtoria për arsim dhe edukim, përkatësisht komisioni për regjistrimin e nxënësve në klasët e dhjeta për të dy shkollat e mesme të larta, për testin e maturës afati i dytë, për administruesit, komisionerët dhe stafin e DKAE-së, në KK-Malishevë.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati

Aktvendimi j u dorëzohet :

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Drejtoria për arsim dhe edukim,
3. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E MALISHEVËS

KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVË

THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO

Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 13/09/2022

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

13-09-2022

01/1597

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja a, b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 13.09. 2022 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 265.00 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për ushqim dhe pije, të shkaktuara nga drejtoria për kulturë, rini dhe sport, me rastin e organizimit të Festivalit “ Oda e LLapushës “ në Malishevë.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati

Aktvendimi ju dorëzohet :

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Drejtoria për kulturë, rini dhe sport,
3. Arkivit të komunës.